



Primitje / Dorezimi Prilje / Prilato Received / Delivered	30.03.2022	2	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtypja Prilog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	1700/2022		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.191/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1974/21 të datës 25.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i pranuar me datë 01.03.2022, ka shqyrtuar ankesën numër A.nr.588/2019 të datës 27.09.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë

Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.588/2019 e datës 27.09.2019 e parashtruar nga ankuesi;
- II. OBLIGOHET Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme që t'ia kompensoi ankuesit ndalesën retroaktive në pagë.
- III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga momenti i pranimit të tij.
- VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim

A r s y e t i m

Ankuesin sipas Akt emërimit të datës 04.04.2013 është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pozitën Operator për Pasaporta Departamenti për Prodhimin e

Dokumenteve në kuadër të Agjencisë për Regjistrim Civil, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrim Civil me vendimin numër protokoll: 02 nr:1099 të datës 06.03.2018 e ka caktuar Ushtrues i Detyrës së Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile.

Ankuesi nga ana e Drejtorit të Drejtoratit të Përgjithshëm të Regjistrimit Qendror është njoftuar fillimisht përmes e-mailit të datës 07.06.2019 e më pas të datës 19.06.2019 se do të kthehet në pozitën e tij paraprake të punës Operator për Pasaporta Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve, ndërsa në pozitën e Ushtrues i Detyrës së Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile do të emërohet

Me datën 31.07.2019 ankuesi e ka pranuar pagën me ndalesën retroaktive prej njëqindeshtatëdhjetegjashtë (176) eurove, ndërsa me datë 02.08.2019 me shkresë i është drejtuar Zyrës së Personelit me kërkesën që t'i kthehen mjetet mirëpo kërkesa e tij nuk është shqyrtuar pasi që më datë 29.08.2019 ankuesit paga i ka dalë sërish me ndalesë retroaktive.

Ankuesi me datë 30.08.2019 i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me shkresën numër 669/19, mirëpo sipas pretendimeve në ankesë e parashtruar në Këshill ankuesi me datë 25.09.2019 është njoftuar verbalisht nga Kryetarit i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, se që nga data 11.09.2019 Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i ka skaduar mandati dhe e ka drejtuar që ankesën ta parashtrojë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Kundër përgjigjes verbale të datës 25.09.2019 të Kryetarit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankuesi me datën 27.09.2019, me numër të protokollit 4557/2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 03.10.2019, me numër protokollit 4646/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datën 09.10.2019 me numër protokollit 4721/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 08.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 31.05.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2804/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 08.11.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendosë për ankesën e ankuesit të datës 27.09.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.06.2021 ka pranuar Aktgjykimin A.nr.2804/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, mirëpo që nuk ka mund të vendos, sepse Kuvendi i Republikës së Kosovës, më datë 30.06.2021 ka shkarkuar të gjithë anëtarët e Këshillit, për këtë situatë është njoftuar ankueses si dhe Gjykata-Gjyqtari i rastit.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative serish me datë 25.02.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1974/21 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 08.11.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankuesit të datës 27.09.2019 me numër A.nr.588/2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 27.09.2019 me numër protokollit 4557/2019 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 30.08.2019 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; kërkesën për kthim të mjeteve të datës 02.08.2019; vendimi e datës 24.11.2017; vendimi i datës 06.02.2018; e-maili i datës 07.06.2019; e-maili i datës 19.06.2019; E-maili i datës 10.07.2019; E-maili i datës 08.07.2019; Kërkesa e datës 02.08.2019; Ankesa e datës 30.08.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 03.10.2019; Përgjigje në kërkesë e datës 09.10.2019; Akt emërimit e ankuesit të datës 04.04.2013; Vendimin e datës 06.03.2018; vendimin e datës 08.07.2019; Lista e pagave për periudhën 01.07.2019 deri 31.07.2019; Lista e pagave për periudhën 01.03.2019 deri 31.03.2019; Lista e pagave për periudhën 01.03.2018 deri 31.03.2018; Lista e pagave për periudhën 01.03.2018 deri 31.10.2019; Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 08.07.2019, Aktgjykimin A.nr.2804/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 31.05.2021; Njoftimin e datës 08.11.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesi i cila pretendon se ndalesa në pagë në mënyrë retroaktive për periudhën prej 01.03.2019 deri në momentin kur e kam Ushtruar Detyrën e Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile është i padrejtë ngase vendimin me numër protokollit:03/31 të datës 08.07.2019 me të cilin jam liruar nga përgjegjësia e Ushtruesit të Detyrës të Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile e kam pranuar përmes e-maili me datë 10.07.2019, dhe po ashtu unë i kam ushtruar detyrat Ushtruesit të Detyrës të Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile deri me datë 19.06.2019 kur edhe e kam pranuar njoftimin fillestar nga Drejtori i Drejtoratit të Regjistrimit Qendror

kur edhe jam i njoftuar fillimisht se në pozitën e Ushtruesit të Detyrës të Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile do të caktohet z.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar që ankuesi sipas Akt emërimit të datës 04.04.2013 është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme në pozitën Operator për Pasaporta Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve në kuadër të Agjencisë për Regjistrim Civil, ndërsa nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrim Civil me vendimin numër protokollit: 02 nr:1099 të datës 06.03.2018 është caktuar Ushtrues i Detyrës së

Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile, me koeficient 8.5 dhe afati i kohëzgjatjes nuk ka qenë i përcaktuar, ndërsa ankuesi është njoftuar fillimisht përmes e-maili të datës 07.06.2019 e më pas të datës 19.06.2019 me përshkrimin se: *“Ju njoftojë se në pozitën e ushtruesit të udhëheqësit të sektorit të regjistrimit qendror të gjendjes civile, të cilën deri me tani e ka ushtruar z.*

*prej sot caktohet ushtrues detyre* mirëpo ankuesi vendimin më numër protokoll: 03 nr.31 të datës 08.07.2019 me të cilin është shfuqizuar vendimi i datës 06.03.2018 me numër protokoll 1099 dhe njëherit ankuesi është kthyer në pozitën e tij paraprake të punës Operator për Pasaporta në Drejtoratin e Prodhimit të Dokumenteve, e ka pranuar me datë 10.07.2019 përmes e-maili, rrjedhimisht ndalesa retroaktive në pagë në shumë prej njëqindeshtatëdhjetegjashtë (176) eurove e konstatuar në bazë të listës së pagave të datës 31.07.2019 me pretendimin se Vendimi me numër protokoll: 03 nr. 31 të datës 08.07.2019 është nxjerrë me datë 01.03.2019 është i pabazuar, ngase aktet administrative nuk mund të prodhojnë efekte juridike para se të njoftohet pala më përmbajtjen e tyre siç është e përcaktuar edhe me dispozitat e Ligjit nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 51 paragrafi 1 dhe 3 i cili përcakton se: *“Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij”* dhe *“Një akt administrativ mund të fillojë të prodhojë pasojat juridike në një datë tjetër, të caktuar shprehimisht nga vetë akti, por në asnjë mënyrë përpara njoftimit të palës në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni. Në këtë rast, data e fillimit të pasojave do të përfshihet shprehimisht në pjesën urdhëruese të aktit administrativ të shkruar”*.

Po ashtu, Kolegji ka gjetur se vendimi numër protokoll: 02 nr:1099 i datës 06.03.2018 me të cilin ankuesi është caktuar Ushtrues i Detyrës së Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile, me koeficient 8.5 nuk e ka pas të specifikuar afatin e kohëzgjatjes dhe i njëjti për ankuesin ka prodhuar efekte juridike deri datën 10.07.2019 kur edhe ka pranuar përmes e-maili vendimin me numër protokoll: 03 nr. 31 siç është e përcaktuar edhe me dispozitat e Ligjit nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 51 paragrafi 3: *“Një akt administrativ do të prodhojë pasoja juridike për atë kohë sa nuk është anuluar apo shfuqizuar sipas detyrës zyrtare apo si rezultat i ushtrimit të mjeteve juridike administrative apo gjyqësore, nuk skadon për arsye të kohës apo përmbushjes së qëllimit të tij, apo nuk pushon së prodhuari të pasojave, për çfarëdo arsye tjetër të paraparë me ligj”*, dhe po ashtu Ministria e Punëve të Brendshme në përgjigjen e datës 09.10.2019 e cila në Këshill është protokolluar me numër 4721/2019 ka specifikuar se, citoj: *“Ministria e Punëve të Brendshme me Vendimin nr.31 të datës 08.07.2019 shfuqizon vendimin e datës 06.03.2018 me numër protokoll 1099 për ku i njëjti kthehet në vendin e tij të punës: Operator për pasaporta, Drejtoratit për Prodhimin e Dokumenteve, Agjencia e regjistrimit Civil/MPB”*, andaj mbi bazën e kësaj ndalesa retroaktive në pagë në vlerën e njëqindeshtatëdhjetegjashtë (176) eurove e zbatuar ndaj ankuesit është e paarsyetuar e paqëndrueshme dhe në kundërshtim me parimet themelore të shërbimit civil të përcaktuara në Ligjin nr.06/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa ankesa e ankuesit është e bazuar.

Kolegji ka vlerësuar se, meqenëse nuk ka mundur të vendos brenda afatit me rastin e parashtrimit të ankesës fillestare me datë 27.09.2019 sipas sqarimeve si në arsyetim të këtij vendimi, konstaton se Agjencia për Regjistrim Civil funksionin në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, andaj Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme obligohet që ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që edhe çdo ndalesë tjetër e pagës në mënyrë retroaktive përveç atyre të evidentuar në shumë prej njëqindeshtatëdhjetegjashtë (176) eurove e konstatuar në bazë të listës së



pagave të datës 31.07.2019 ndërlidhur me rastin konkrete duhet ti kompensohet ankuesit për kohën deri kur i njëjti e ka ushtruar pozitën e Ushtruesit të Detyrës dhe e ka pranuar zyrtarisht vendimin me numër prot: 03 nr.31 të datës 08.07.2019 i konfirmuar edhe nga ana e Ministrisë Punëve të Brendshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Agjencia e Regjistrimit Civil me rastin e ndalesës retroaktive në pagë për ankuesin ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe bazën juridike, ndërsa ankesa e ankuesit është e bazuar.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: "Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës", dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: "Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit".

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda A.nr.191/2022

Flakron Gashi



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Regjistrimit Civil;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK- së.